

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
ndërmjet
INSPEKTORIATIT TE LARTE TE DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TE PASURIVE
dhe
INSTITUTIT TE TRAJNIMEVE TE ADMINISTRATES PUBLIKE

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive në mbështetje të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" nenit 42, pika 1, shkronjat a) dhe ç), "drejton dhe përmirëson politikat dhe mekanizmat e parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesave, forcon kapacitetet për administrimin e konfliktit të interesave në institucionet publike".

Instituti i Trajnimit të Administratës Publike në bazë të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil", si dhe të VKM nr. 315, datë 3.6.2000 funksionon si i vetmi institucion buxhetor që ofron trajnime për punonjësit e administratës publike në fusha të ndryshme.

Përsa më sipër, Palët bien dakort të respektojnë qëllimin e kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi

- Realizimi i bashkëpunimit të ndërsjelltë ndërmjet dy palëve për trajnimin e zyrtarëve të administratës publike, në çështje të konfliktit të interesit dhe deklarimit të interesave private.
- Bashkërendimi i veprimeve të ILDKP-së dhe ITAP-it në bazë të ligjit "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr. 172, datë 2.11.2005 "Për marrjen e masave të shpejta në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005".

Neni 2
Detyrimet e ILDKP

ILDKP-ja merr përsipër:

- të verë në dispozicion të aktiviteteve trajnuese, trajnerët e çertifikuar të saj, sipas miratimit të Inspektorit të Përgjithshëm;
- të përgatitë ftesat dhe programin për çdo trajnim;
- të lajmërojë zyrtarët, që duhet të marrin pjesë në trajnim;

Neni 3
Detyrimet e ITAP

ITAP merr përsipër:

- bën pagesën e lektorëve, sipas VKM-së nr.242, datë 16.4.2004 dhe legjislacionit në fuqi;
- siguron sallat ku kryhet trajnimi dhe pajisjet logjistike të nevojshme për kryerjen e tij;
- mban bazën e të dhënave të pjesëmarrësve të çertifikuar dhe të trajnerëve, sipas kurseve.

Neni 4
Detyrime të përbashkëta

ILDKP-ja dhe ITAP-i marrin përsipër:

- bashkërendimin e temave të lektorëve, sipas specifikave të çdo grupi që do të trajnohet;
- hartimin e një plani trajnimesh, ku përfshihen numri i zyrtarëve që do të trajnohen, funksionet, koha, vendi, si dhe numri gjithsej i ditëve të trajnimit;
- shpërndarjen e çertifikatës për pjesëmarrësit, sipas modelit të përcaktuar nga Palët.

Neni 5
Komunikimi

Palët do të caktojnë person kontakti, që do të jenë përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes. Në përfundim të ciklit të trajnimeve, personat e kontaktit, duhet të përgatisin një raport me shkrim për titullarët e institucioneve përkatëse, për rezultatet dhe çdo të dhënë tjetër që lidhet me trajnimet e përbashkëta.

Neni 6
Ndryshime

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjellë me shkrim të palëve.

Neni 7
Përfundimi i Marrëveshjes

Marrëveshja mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga Pala tjetër. Deri në përfundimin e kësaj Marrëveshjeje, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, përsa i përket informacionit dhe dokumenteve të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të saj.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e palëve. Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe dy të tjera në Institutin e Trajnimit të Administratës Publike.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u lidh sot më datë 6 shtator 2007.

**Per Inspektoriatin e Larte te
Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive**

**INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
FATMIRA LASKA**

**Per Institutin e Trajnimit
te Administrates Publike**

**DREJTOR
FATMIR DEMNERI**